 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Ankes 4: Politika dhe objektivat e Cilësisë	Kodi DA-PO-001
		Rishikim nr 3 Dt 22.12.2014
		Faqe 1 nga 2

Politika e Cilësisë

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për të përmbushur misionin e saj ka krijuar dhe mirëmban sistemin e menaxhimit të cilësisë i cili bazohet në në legjislacionin në fuqi, në standardet ndërkombëtare për fushën e akreditimit dhe në dokumenta të tjera, të nxjerra nga organizmat europianë dhe ndërkombëtarë të akreditimit. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ofron shërbimin e akreditimit në mënyrë profesionale, të paanëshme, transparente si dhe ajo është e vetëdijshme për rolin e saj. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është pjesë e infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri dhe luan një rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e ekonomisë Shqiptare.


Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit premtion përmirësim të vazhdueshëm të performancës së saj në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në pajtueshmëri me kërkesat e standardeve nuk do të ofrojë shërbime të tilla si shërbime konsultimi për të fituar apo mbajtur akreditimin apo aktivitete të tjera të cilat mund të ndikojnë në besueshmërinë dhe paanëshmërinë e saj.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit është i planifikuar, i dokumentuar, i zbatuar dhe i kontrolluar. Ne kontrollojme zbatimin e politikës së cilësisë dhe politikave të tjera nëpërmjet rezultateve të auditimeve të brendshme, kënaqësisë së klientëve dhe autoriteteve, statusit të efektivitetit të veprimeve korrigjuese dhe parandaluese, masave që rrjedhin nga rishikimi i menaxhimit, ndryshimeve që mund të ndikojnë në sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe rekomandimeve për përmirësim.

Ne jemi të ndërgjegjshëm që vetëm një staf i trajnuar dhe kompetent me eksperiencë praktike është çelsi për një performancë të përshtatshme dhe efektive të procedurave të akreditimit. Ne do të organizojmë trajnime të vazhdueshme për stafin tonë (të brendshëm dhe të jashtëm) dhe do të kontrollojmë efektivitetin e tyre.

Stafi i DPA është i vetëdijshëm që sistemi i menaxhimit të cilësisë duhet të zbatohet pa shmangie dhe mangësira dhe se ai do të zbatohet nga çdo person i cili është i përfshirë në aktivitetet e DPA-së.

Për realizimin e politikës së cilësisë DPA ka përcaktuar objektivat e cilësisë të cilat i bashkëngjiten kësaj politike.

 Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al	Ankes 4: Politika dhe objektivat e Cilësisë	Kodi DA-PO-001
		Rishikim nr 3 Dt 22.12.2014
		Faqe 2 nga 2

Stafi i DPA është i vetëdijshëm që sistemi i menaxhimit të cilësisë duhet të zbatohet pa shmangie dhe mangësira dhe se ai do të zbatohet nga çdo person i cili është i përfshirë në aktivitetet e DPA-së.

Tiranë më 22.12.2014

Drejtore i Përgjithshëm

Armond HALEBI